

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: BOE “ALBAVIA” sh.p.k., NIPT J81527001Q, (83.99) %, Adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, pallati Fati, shk. 1, ap. 19, Tiranë, & “AlbPower Energy” sh.p.k., NIPT M31620031D, (16.01) % Adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Ap. Nr. 10, Zona Kadastrale Nr. 8270, Tiranë.

- **OE/BOE me Nënkontraktor:**

PO ☐ **JO** ☒

-**OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: Kontratë Publike për Shërbime.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – me Mjete elektronike.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **NR. REF –62799-09-26-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese e impiantit fotovoltai në digën e Qyrasqit për një periudhë 2 vjeçare”. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 (njëzet e katër) muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 12/11/2025.

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Buletini Nr.71, datë 17/11/2025.*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1) BOE “ALBAVIA” sh.p.k., NIPT J81527001Q, (83.99) % & “AlbPower Energy” sh.p.k., NIPT M31620031D, (16.01) % me vlerë oferte 34,998,900 (Tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

2) BOE “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, (50) % & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k., NIPT K21731001O, (50) %, me vlerë oferte 36,500,000 (Tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

3) OE “SOLAR ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., NIPT L73120201J, me vlerë oferte 39,365,690 (Tridhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

 **BOE “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, (50) % & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k., NIPT K21731001O, (50) %, pasi:**

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k, NIPT K21731001O, nuk ka paraqitur Marrëveshje bashkëpunimi, në kundërshtim me nenin 88 - Bashkimi i operatorëve ekonomikë të VKM Nr.285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të DT, shtojca 9 - **kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit ku citohet se:**
Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Mungesa e këtij dokumenti, e bën të pamundur vlerësimin në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik.
- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k., NIPT K21731001O, nuk plotëson kriterin teknik, pika 2.3.5 pasi nuk kanë plotësuar në mënyrë të detajuar pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), të shtojcës 10 - FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, për disponimin minimalisht të 1 (një) specialisti të çertifikuar për sistemet SCADA.
- Sigurimi i ofertës, i referohet llojit të procedurës e Hapur, dhe jo sipas pikës 4.1 të DT, ku konstatohet se Lloji i procedurës është: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – me Mjete elektronike.
- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k., NIPT K21731001O, në shtojcën 2 - *Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit për zërin Nr. 2: Mirëmbajtja korrigjuese dhe parandaluese periodike sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike ka ofertuar çmimin për njësi vlerën prej 1.825.000 Lek pa TVSH si dhe çmimin total vlerën prej 1.825.000 Lek pa TVSH.* Nga konstatimi i termave të referencës dhe specifikimeve teknike, rezulton se në pikën 7 - Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit ky zë duhet të ofertohej për 24 muaj, pra çmim njësi/për muaj.
- FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, sipas shtojcës 10 paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Deutsche Energie & Technologie” sh.p.k, NIPT L51424006O, & “ELEKTRO – METAL.PP” sh.p.k., NIPT K21731001O, nuk është i rregullt pasi në fillimin e këtij formulari përmbledhës vetëdeklarimi cilësohen të dy administratorët si nënshkrues.

 **OE “SOLAR ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., NIPT L73120201J, pasi:**

- OE “SOLAR ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., NIPT L73120201J, nuk plotëson kriterin teknik, pika 2.3.5 pasi nuk ka plotësuar në mënyrë të detajuar pikën B - Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), të shtojcës 10 - FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT, për disponimin minimalisht të 1 (një) specialisti të certifikuar për sistemet SCADA.
- OE “SOLAR ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k., NIPT L73120201J, ka plotësuar shtojcën 2 në kundërshtim me pikën 7 - Tabela përmbledhëse e ofrimit të shërbimit të Termave të Referencës dhe Specifikimeve Teknike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: BOE “ALBAVIA” sh.p.k., NIPT J81527001Q, (83.99) %, Adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, pallati Fati, shk. 1, ap. 19, Tiranë, & “AlbPower Energy” sh.p.k., NIPT M31620031D, (16.01) % Adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Ap. Nr. 10, Zona Kadastrale Nr. 8270, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 34,998,900 (Tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta fituese. **(Në zbatim të vendimit nr. 107/2026, datë 20/01/2026, të Komisionit të Prokurimit Publik).**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare), Adresa: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit:

PO X JO

Vendimet përfundimtare për shqyrtimin e ankesave, të dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik:

- Vendim Nr. 107/2026, datë 20/01/2026 i Komisionit të Prokurimit Publik.
- Vendim Nr. 196/2026, datë 03.02.2026, i Komisionit të Prokurimit Publik (Për heqjen e pezullimit).

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Viola Haxhiademi